



**VENDIM**

*Nr. 152, Datë 30.09.2016*

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE  
MIRATIMIN E DRAFT – RREGULLORES PËR PROCEDURAT  
E LICENSIMIT, MODIFIKIMIT, TRANSFERIMIT TË  
PJESSHËM OSE TË PLOTË, HEQJEN E LICENSAVE NË  
SEKTORIN E GAZIT NATYROR.**

Ne mbeshtetje të nenit 24 të Ligjit Nr. 102 /2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe të nenit 26 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin Nr 96 date 17.06.2016 te Bordit te ERE, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 30.09.2016, pasi shqyrtoi relacionin e draft – Rregullores Rregullores për Procedurat e Licensimit, Modifikimit, Transferimit të pjesshëm ose të plotë, Heqjen e Licensave në Sektorin e Gazit Natyror të përgatitur nga grupi i punes,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e draft – Rregullores për Procedurat e Licensimit, Modifikimit, Transferimit të pjesshëm ose të plotë, Heqjen e Licensave në Sektorin e Gazit Natyror.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë palet e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.
- 3.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**